



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,  
trajtimin ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruar

Tel/Fax:+355 4 2380 300/315

E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)

[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 202000012/2

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2020

**Lënda :** Rekomandime mbi inspektimin e bërë në Komisaratin e Policisë Dibër.

**Drejtuar:** Drejtues i parë Skënder KALEMI  
Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër

**Z. Gazmend DEMROZI**  
Shef i Komisariatit të Policisë Dibër

**PESHKOPI**

**Për dijëni:** Drejtues Madhor Ardi VELIU  
Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit

**TIRANË**

*Të nderuar zotërinj,*

Avokati i Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimin ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruar, në vijim Mekanizmi Kombëtar<sup>1</sup>, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, kreu një inspektim në Komisaratin e Policisë Dibër.

Inspektimi u krye në datën 07.11.2019, sipas Planit të Inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin z.Besnik Deda dhe z.Genci Tërpo me detyrë Nd/komisioner pranë Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, si dhe z.Sotirag Nushi me detyrë Nd/komisioner pranë Seksionit të Veçantë.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në ligjin nr.108/2014, "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar, Urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, për miratimin e procedurës standarde "Trajtimi dhe Sigurimi i Personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre", Urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.306, datë 31.03.2016, për miratimin e procedurës standarde "Rregullat teknike të shoqërimit në polici", si dhe zbatimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit të bëra në inspektimet e mëparshme.

<sup>1</sup> Neni 74/1 i ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", i ndryshuar.

Avokati i Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit të inspektimit, ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t'ju parashtrorë konkluzionet përfundimtare, duke ju referuar si më poshtë vijon:

### **Shënime të përgjithshme**

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen e trajtohen shtetas të privuar nga liria, grupi i punës në mungesë të Shefit të Komisarariatit të Policisë Dibër, u takua me shefin e rendit z.Gani Rada, i cili u vu në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit.

Shefi i rendit, informoi grupin e inspektimit mbi gjendjen dhe kushtet në të cilën ndodhen ambientet e shoqërimit dhe sigurisë në këtë Komisarariat, si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit, për përmirësimin e kushteve dhe trajtimin e shtetasve që qëndrojnë në këto ambiente, konform kërkesave të parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore për këtë qëllim.

Grupi i inspektimit, pasi mori informacionin e nevojshëm lidhur me qëllimin e inspektimit, vijoi takimin me punonjësit e policisë të zyrës së informacionit dhe përgjegjësën e dhomave të sigurisë. Theksojmë se, shefi i rendit dhe punonjësit e policisë u treguan bashkëpunues dhe transparentë gjatë komunikimit dhe inspektimit që zhvilloi grupi i inspektimit në ambientet e këtij Komisarariat.

Në vijim, grupi i inspektimit vizitoi dhomat e shoqërimit, dhomat e sigurisë, zyrat e punonjësve të policisë që kryejnë veprime proceduriale me shtetasit e shoqëruar dhe të arrestuar apo ndaluar, si dhe u njoh dhe administroi dokumentacionin përkatës ku pasqyroheshin veprimet e kryera me këta persona.

Në Komisarariatin e Policisë Dibër, nga informacioni i grumbulluar gjatë kryerjes së inspektimit në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit, rezultoi se:

1. **Nuk ishte plotësuar rekomandimi**, për mbylljen e ambienteve ekzistuese të sigurisë në këtë komisarariat, si dhe ndërtimin e ambienteve të reja të sigurisë, sipas kushteve dhe kriterëve ligjore të ndërtimit dhe funksionimit të tyre;
2. **Nuk ishte plotësuar rekomandimi**, për ndërtimin dhe vënien në funksionim të ambienteve të shoqërimit, për mbajtjen dhe sigurinë e personave të shoqëruar, të ndara më vete për femra, personat e rritur dhe të mitur.
3. **Nuk ishte plotësuar rekomandimi**, për krijimin e dhomave (zyrave) ku merren në pyetje personat e shoqëruar dhe të ndaluar/arrestuar, si dhe instalimin brenda tyre të sistemit të monitorimit me kamera.

Ndërkohë, grupi i inspektimit konstatoi se, **ishte realizuar rekomandimi për mbylljen dhe vulosjen e dy dhomave ekzistuese të shoqërimit**, të përcaktuara jashtë kushteve teknike dhe të sigurisë për personat e shoqëruar në këto mjedise.

Institucioni i Avokatit të Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga inspektimi i vitit të kaluar, ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t'ju parashtojë konkluzionet përfundimtare, duke ju referuar si më poshtë vijon:

### **Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre**

Në Komisarlatin e Policisë Dibër, ambientet e shoqërimit në tërësi nuk janë të ndërtuara sipas kërkesave të ligjit nr. 108/2014, "Për Policinë e Shtetit" dhe Urdhërit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.306, datë 31.03.2016, për miratimin e procedurës standarde "Rregullat teknike të shoqërimit në polici", ku theksohet se: "Mjedisi/ambienti duhet të jetë me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrim.....si dhe të ndara më vete për femrat, meshkujt madhorë dhe të miturit".<sup>2</sup>

Ambienti i shoqërimit ndodhej në katin e parë të ndërtesës së këtij komisarlati dhe kishte vetëm një dhomë shoqërimi, e cila përdorej për shoqërimin e shtetasve të rritur. Në rastet e shoqërimit dhe intervistimit të personave femra dhe të mitur, përdorej një dhomë (zyrë) e cila ndodhej në katin e dytë të godinës.

Në koridorin e këtij ambienti, kishte edhe dy dhoma të tjera të ndara me zgarë hekuri, të cilat ishin të mbyllura dhe të vulosura, pasi ato ishin përcaktuar nga Institucioni i Avokatit të Popullit, jashtë kushteve teknike dhe sigurisë të personave të shoqëruar.

Dhoma ishte me përmasa 6x5m dhe mbyllej me derë druri, ndërsa dritarja ishte e madhe dhe lejonte ajrim dhe ndriçim natyral. Ndërkohë, ndriçimi artificial sigurohej nga rrjeti elektrik. Dhoma e shoqërimit ishte e pa lyer, por ishte e pastër dhe e pajisur me orenditë e nevojshme, si tavolinë dhe karrige për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar.

Për mbajtjen dhe intervistimin e të shoqëruarëve femra dhe të mitur përdorej një dhomë e cila ndodhej në katin e dytë të godinës së komisarlatit. Asnjëra prej dhomave të shoqërimit nuk kishte sistem ngrohje. Në koridorin e godinës, afër dhomës së shoqërimit ndodhej vetëm një tualet, por dhe ai ishte jashtë funksionit.

Në këtë Komisarlat, nuk ishte i instaluar sistemi i monitorimit me kamera për mbajtjen në vëzhgim të korridorit dhe ambientit të shoqërimit.

Avokati i Popullit, në vite i ka rekomanduar autoriteteve përgjegjëse si Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë të Shtetit, ndërtimin e ambienteve të shoqërimit dhe ato të sigurisë në Komisarlatin e Policisë Dibër, konform akteve normative në fuqi, me qëllim krijimin e kushteve për trajtim dinjitoz të shtetasve të shoqëruar dhe të arrestuar/ndaluar, sikurse përcaktohet në ligjin nr.108/2014, "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar, Urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, për miratimin e procedurës standarde "Trajtimi dhe Sigurimi i Personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre", Urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.306, datë 31.03.2016, për miratimin e procedurës standarde "Rregullat teknike të shoqërimit në polici".

---

<sup>2</sup> Kreu VI, pika 3 e procedurave standarde "Rregullat teknike të shoqërimit në polici".

Por, konstatojmë se ende nuk janë ndërmarrë veprime konkrete për të planifikuar dhe siguruar fondet e nevojshme për ndërtimin e ambienteve të reja apo rikonstruksionin e ambienteve ekzistuese, duke kaluar një kohë e gjatë, për të marrë masat për të garantuar të drejtat që ju njih ligji personave të shoqëruar në mjediset e policisë dhe të ndaluar/arrestuar, në mënyrë efektive.

### **Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre**

Në Komisarlatin e Policisë Dibër, ndërtimi dhe funksionimi i ambientit të sigurisë, nuk ishte sipas normave, parametrave dhe standardeve të BE-së, përcaktimeve të bëra në Konventën “Për parandalimin e Torturës dhe Trajtimeve Çnjerëzore dhe Degraduese”, si dhe Urdhërit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, për miratimin e procedurës standarde “Trajtimi dhe Sigurimi i Personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”.

Konkretisht, në këtë Komisarlat kishte 13 dhoma sigurie, nga të cilat ishin në përdorim vetëm 5(pesë) dhoma për personat e arrestuar/ndaluar. Dhomat e tjera ishin të mbyllura dhe të vulosura, pasi ato ishin jashtë kushteve teknike dhe kriterëve për mbajtjen, sigurimin dhe trajtimin e personave të arrestuar/ndaluar.

Kapaciteti i dhomave të sigurisë ishte për qëndrimin e 5(pesë) personave, por sipas informacionit, në raste të veçanta brenda tyre janë akomoduar edhe më shumë se 5(pesë) persona. Ky mbipopullim, u evedentua qartë në regjistrin e të dhënave të personave të ndaluar/arrestuar që ndodhej në ambientin e sigurisë.

Rasti më evident ishte ai i datës 28.06.2019, ku një grup personash në Bashkinë e Dibrës kanë protestuar dhe organi i policisë ka pretenduar se, ata kanë tentuar të futen me forcë në ambientet e shkollës profesionale “Nazmi Rushiti” të qytetit të Peshkopisë, ku ndodhej Komisioni Zonal i Administrimit të Zgjedhjeve nr.19 Dibër (KZAZ nr.19 Dibër) për të shkatërruar materialet zgjedhore, para zgjedhjeve vendore të datës 30.06.2019.

Komisariati i Policisë Dibër dhe punonjës të strukturave të Policisë së Shtetit të ardhura në ndihmë të tyre, në orët e para të mëngjesit të datës 29.06.2019, kanë arrestuar 13 nga personat e dyshuar si autorë të kësaj ngjarjeje dhe në shkelje të të drejtave të tyre ligjore, janë dhunuar fizikisht këta persona nga punonjës të policisë të strukturave në Policinë e Shtetit.

Lidhur me këtë rast, Avokati i Popullit bazuar në nenin 13 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, ka filluar me nismën e vet shqyrtimin e rastit të bërë publik nga media të ndryshme vizive dhe të shkruara.

Në përfundim të hetimit administrativ të këtij rasti, Institucioni i Avokatit të Popullit arriti në konkluzionin se, nga punonjësit e strukturave të Policisë së Shtetit janë kryer një sërë shkeljesh ligjore si më poshtë:

- a) Shoqërimi i një numri personash në orët e natës duke filluar nga ora 03:00 është bërë jashtë kushteve të flagrancës dhe kur ata ishin larguar për në banesat e tyre.
- b) Dhunimi fizik e psikologjik i të shoqëruarve;
- c) Mbajtja për 9 orë e tyre në ambientet e shoqërimit pa akt dhe përpilimi i procesverbaleve të arrestimit në flagrancë pas kësaj periudhe kohore;
- ç) Mosdhënia e ndihmës mjekësore menjëhere të dëmtuarve nga dhuna e ushtruar;

d) Ndërhyrja në banesa pa akt të motivuar dhe për më tepër me iniciativë nga punonjësit e strukturave të Policisë së Shtetit;

dh) Shoqërimi dhe arrestimi i dy personave për të cilët nga organi i prokurorisë nuk është konstatuar që të kenë qënë në protestë;

e) Atribuimi i 6 fakteve penale, ndërkohë që organi i Prokurorisë ka regjistruar procedimin penal vetëm për 3 akuza;

ë) Dërgimi i akteve nga Komisariati i Policisë në organin e Prokurorisë në datën 30.06.2019, me gati 30 orë vonesë;

f) Mos shoqërimi i të arrestuarve në Gjykatë për vleftësimin dhe caktimin e masës së sigurisë në datën 01.07.2019, duke e refuzuar kërkesën e Gjykatës;

k) Mos njoftimi i prokurores dhe kryerja me iniciativë e veprimeve me të arrestuarit;

l) Mbajtja pa dijeninë e organit procedues të 26 personave në kërkim policor dhe pa masa sigurie personale.

Për sa më sipër, **Avokati i Popullit me shkresën nr.K2/I35-2Prot., datë 15.07.2019** drejtuar organit të Prokurorisë të Rrethit Gjyqësor Dibër dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, **ka rekomanduar:** *“Fillimin e hetimeve ndaj punonjësve të strukturave të Policisë së Shtetit që kanë shkuar në ndihmë të DVP Dibër, për veprën penale të “Kryerjes së veprimeve arbitrare”, në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 250 dhe 25 të Kodit Penal, të ndryshuar, si dhe ndaj drejtuesit të Komisarariatit të Policisë Dibër për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, të ndryshuar”.*

Gjatë inspektimit, u konstatua se dhomat e sigurisë ishin të ndara në 3(tre) dhoma për personat e rritur, 1(një) dhomë për femra dhe 1(një) dhomë për të mitur. Por, ato nuk plotësonin normat dhe parametrat teknikë jetësorë, atë të hapsirës dhe sipërfaqes për një person të arrestuar/ndaluar, pasi sipërfaqja e përgjithshme ishte më pak se 10 metra<sup>2</sup>, dhe nuk ishte e ndarë në ambient qëndrimi (dhomë) me sipërfaqe 6 m<sup>2</sup> dhe paradhomë me sipërfaqe 4 m<sup>2</sup>.<sup>3</sup>

Dritaret e dhomave ishin të vogla dhe nuk mundësonin futjen e sasisë së mjaftueshme të ajrit dhe dritës natyrale. Ndërsa ndiçimi artificial sigurohej nga rrjeti elektrik dhe një gjenerator për rastet kur kishte ndërprerje të energjisë elektrike.

Për personat e ndaluar/arrestuar **nuk** kishte krevatë në dhoma, ndaj këta persona flinin me dyshekë që vendoseshin në dyshemenë prej dërrase. Dhomat ishin të pajisura me materialet e fjetjes si dyshekë e batanije, por ato ishin shumë të vjetëruara. Nga informacioni, rezultoi se materialet e fjetjes nuk ishin rinovuar prej 8 vitesh.

Ambienti i sigurisë kishte shumë lagështirë dhe ishte i amortizuar në tërësi. Qëndrimi i shtetasve të arrestuar/ndaluar në këto kushte, përbën trajtim degradues.

Të ndaluarit/arrestuarit kishin akses për larje e pastrim të vazhdueshëm në tualetet që ndodheshin në korridorin e ambientit të sigurisë, ndërsa për larjen e trupit kishte ambient të posaçëm (dushe me ujë të ngrohtë). Në ambientet e sigurisë nuk kishte sistem ngrohjeje me kaldajë për dimër, sikurse parashikohet në pikën 3/c, Kreu VIII të procedurës standarde. Për shkak të kushteve të rënduara atmosferike në periudhën e dimrit të kësaj

---

<sup>3</sup> Kreu VIII, pika 3/3.3 e procedurës standarde “Trajtimi dhe Sigurimi i Personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”.

zone, ngrohja sigurohej me pajisje elektrike të siguruara nga vetë institucioni, të cilat administroheshin nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë.

Në korridorin e ambientit të sigurisë **nuk** kishte aparat telefonik fiks apo citofon për t'u përdoruar nga punonjësit e shërbimit në rastet e tentativave apo ngjarjeve të rënda me të ndaluarit/arrestuarit, për të kërkuar ndihmë dhe ndërhyrje të shpejtë. Po ashtu, në dhomat e sigurisë mungonte butoni me zile për njoftimin e personelit të shërbimit, në rastet e nevojave nga personat e ndaluar/arrestuar.

Brenda ambienteve të sigurisë kishte një dhomë për kryerjen e vizitave mjekësore, e cila ishte e pajisur me krevat, tavolinë dhe karrige. Dhoma e mjekut, nuk përmbushte standardet pasi ishte e pandriçuar mirë, e ftohtë dhe e papërshtatshme për kryerjen e vizitave mjekësore.

Gjithashtu, në ambientin e sigurisë ishte edhe një dhomë për takimin e të ndaluarve/arrestuarve me avokatët dhe për pyetjen e tyre nga oficerët e policisë gjyqësore. Kjo dhomë ishte e pajisur me tavolinë dhe karrige, por nuk ishte e monitoruar me sistemin e kamerave.

Në rastin e marrjes në pyetje të të miturve, nga oficerët e policisë gjyqësore/prokurori, mungonte ambienti më vete me kushte të përshtatshme, sikurse përcaktohet në të drejtat për të miturit në procedurën standarde për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar<sup>4</sup>.

Hyrja kryesore e ambientit të sigurisë, korridori i tij dhe hyrjet në dhomat e sigurisë nuk monitoroheshin gjithashtu nga sistemi i kamerave.

Në momentin e inspektimit, në dhomat e sigurisë nuk ndodhej asnjë person i ndaluar/arrestuar.

### **Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar dhe evidentimi i tyre**

Në Komisaratin e Policisë Dibër “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr.1” konform Urdhërit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.306, datë 31.03.2016, për miratimin e procedurës standarde “*Rregullat teknike të shoqërimit në polici*”. Regjistri ishte i sekretuar.

Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit” regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se të gjitha rubrikat e tij ishin plotësuar me përgjegjësi nga punonjësit e zyrës së informacionit. Koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta.

Ndërsa të ndaluarit/arrestuarit që trajtoheshin e siguroheshin në ambientet e sigurisë në këtë Komisarati evidentoheshin në regjistrin e personave të ndaluar/arrestuar, i cili ishte i sekretuar. Ky regjistër ishte i plotësuar me korrektësi në të gjitha rubrikat e tij.

---

<sup>4</sup>Kreu VI, pika 2/2.16 e procedurës standarde “Trajtimi dhe Sigurimi i Personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”.

Referuar rastit të lartpërmendur të datës 28.06.2019, gjatë arrestimit të 13 personave të dyshuar për veprën penale të parashikuar në nenet 326/a-25-22, 150-25, 242-22, 236/2, 262/1 dhe 274-25 të Kodit Penal, Institucioni i Avokatit të Popullit konstatoi se, punonjësit e Komisarariatit të Policisë Dibër kanë shkelur kërkesat e nenit 112/2/e të ligjit “Për Policinë e Shtetit” ku parashikohet se, në rastet e arrestimit/ndalimit policia evidenton për çdo person të dhënat për orën, datën dhe vendin e arrestimit apo të ndalimit.

Përsa më sipër, bazuar në aktet ndërkombëtare dhe ato kombëtare, nëse një person arrestohet në flagrancë apo ndalohet, në procesverbalin përkatës të arrestimit/ndalimit duhet të vihet çasti, ora, e kapjes së tij në fakt, kur ai është privuar realisht nga liria. Pra, sapo ai kapet dhe prangoset nga punonjësi i policisë që ka bërë kapjen në flagrancë apo ora kur bëhet ekzekutimi i urdhrit të ndalimit. Duke iu referuar neneve 144, 250 të K.Pr.Penale, shënimi në procesverbal i çastit (orës) së arrestimit në flagrancë ose i ndalimit është një element i rëndësishëm mbi bazën e të cilit fillojnë të llogariten efektet e paraburgimit. Ndërsa në bazë të nenit 258 të K.Pr.Penale, nga çasti (ora) e arrestimit ose ndalimit fillon afati i 48-të orëve, brenda të cilit prokurori kërkon vleftësimin e masës së sigurimit në gjykatën e vendit ku është kryer arrestimi ose ndalimi.

Theksojmë se, në procesverbalet e arrestimit të shtetasve të përpiluara nga oficerët e policisë gjyqësore të organeve vendore të Policisë së Shtetit Dibër, ora e arrestimit të tyre nuk ishte e saktë, sepse ishte vendosur ora e mbajtjes së proceverbaleve dhe jo ora faktike e arrestimit të tyre. Diferenca kohore ndërmjet orës faktike dhe asaj të vendosur në procesverbal është mesatarisht rreth 9 orë për secilin të arrestuar. Kjo do të thotë se kërkesa e organit të prokurorisë për vleftësimin dhe caktimin e masave të sigurimit personal ndaj 13 shtetasve të arrestuar ka shkuar në gjykatën përkatëse tej afatit prej 48 orëve nga arrestimi i tyre në fakt.

Avokati i Popullit, në rekomandimet e bëra në vijimësi që prej më shumë se dhjetë vjetësh, nisur nga rastet e ankesave të trajtuara ashtu edhe nga inspektimet e bëra në organet e Policisë së Shtetit ka kërkuar që, edhe në rastet kur për personat e shoqëruar në organet e policisë vendoset arrestimi apo ndalimi, në procesverbalin e arrestimit në flagrancë ose të ndalimit, duhet të vihet ora faktike e shoqërimit të tyre dhe jo ora kur përpilohet procesverbali i arrestimit/ndalimit.

Rekomandimet e Avokatit të Popullit janë bazuar jo vetëm në parimet universale të së drejtës dhe në parimet e përgjithshme të së drejtës tonë penale, por edhe në dispozitat konkrete të Kodit të Procedurës Penale respektivisht nenet 144, 250 dhe 259 të tij.

Është e nevojshme që të sqarojmë se këto rekomandime janë vlerësuar të drejta dhe janë pranuar nga Policia e Shtetit. Për këtë fakt i referohemi edhe përgjigjeve të dërguara nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit respektivisht me shkresat nr. 12/1 prot., datë 13.02.2018 dhe nr. 267/1 prot., datë 07.03.2018.

### **Trajtimi i të ndaluarve/arrestuarve dhe i të shoqëruarve në ambientet e policisë.**

Në kohën e inspektimit në ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë në Komisariatin e Policisë Dibër nuk kishte asnjë person të shoqëruar dhe të arrestuar/ndaluar.

Grupi i inspektimit u informua nga punonjësit e policisë se personat e arrestuar/ndaluar, trajtohen në mënyrë korrekte gjatë kohës së marrjes në pyetje nga oficerët e policisë gjyqësore dhe qëndrimit në ambientin e sigurisë.

Shtetasit e intervistuar vihen në dijeni për identitetin e punonjësit të policisë me të cilin marrin kontakt dhe kryejnë veprimet procedurale. Të intervistuarit shpjeguan se, gjatë shoqërimit apo arrestimit të tyre, punonjësit e policisë identifikohen përpara tyre duke u prezantuar me gjeneralitetet dhe detyrën që kryenin.

Nga informacioni i dhënë nga punonjësit e policisë që shërbenin në dhomat e sigurisë dhe personat e arrestuar/ndaluar rezultoi se, të ndaluarit/arrestuarit trajtoheshin me ushqim që gatuhet në kuzhinën e komisariatit, tre herë në ditë sipas normave për trajtimin me ushqim të përcaktuar në urdhrin e përbashkët nr.432, datë 10.03.2008 të Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Shëndetësisë.

Ndonëse në dhomat e sigurisë nuk kishte ambiente kulti, të ndaluarve/arrestuarve që dëshironin u lejohej ushtrimi i riteve fetare brenda dhomave të sigurisë ose në ambientin e ajrimit i cili ndodhej në fundin e koridorit të dhomave të sigurisë.

Të ndaluarve/arrestuarve ju jepeshin produkte për ruajtjen e higjienës vetjake dhe të ambientit, si sapun, detergjente, letra higjienike dhe letra për fshirjen e duarve dhe të fytyrës.

### **Ambientet e intervistimit**

Në ambientet e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Dibër, kishte një dhomë për marrjen në pyetje të shtetasve të ndaluar/arrestuar nga përfaqësuesit e akuzës dhe për takim me avokatët, e cila nuk monitorohej me kamera.

Shtetasit e ndaluar/arrestuar, para se të ndaloheshin apo arrestoheshin dhe hynin në ambientet e sigurisë, intervistoheshin nga oficerët e policisë gjyqësore në zyrat e punës së këtyre të fundit. Këto zyra nuk ishin të monitoruara me kamera. Ndërkohë në këtë Komisarariat nuk kishte ambiente të veçanta hetimi për personat e rritur dhe as për të miturit, të cilat të ishin të monitoruara me sistemin e kamerave gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore.

Avokati i Popullit e konsideron procesin e monitorimit filmik një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit ndaj tyre.

Nga monitorimi në kohën e inspektimit i zyrave të oficerëve të policisë gjyqësore në këtë komisarariat, nuk u gjetën sende prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale. Në këtë komisarariat ishte krijuar një ambient i veçantë (magazine) për administrimin dhe ruajtjen e provave materiale.

### **Ndihma juridike, psikologjike dhe kujdesi mjekësor**

Gjatë inspektimit u konstatua se, në korridorin e ambienteve të sigurisë dhe të shoqërimit në Komisarariatin e Policisë Dibër ishin të afishuara postera me të drejtat e personave të ndaluar/arrestuar, si dhe atyre të shoqëruar, të cilat ishte e nevojshme të rinovoheshin me postera të rinj.



Ndërsa për shtetasit e ndaluar/arrestuar të huaj, kishte letra me të drejtat e të ndaluarve/arrestuarve në 9-të gjuhë të huaja, si anglisht, frëngjisht, italisht, greqisht, gjermanisht, maqedonisht, serbisht, sllovenisht dhe rome.

Sipas informacionit të punonjësve të policisë, personat e ndaluar/arrestuar dhe të shoqëruarit njiheshin me të drejtën për të pasur një avokat mbrojtës gjatë marrjes në pyetje. Personat që e kishin kërkuar mbrojtjen me Avokat, ju ishte krijuar mundësia reale për të kontaktuar me avokatë sipas listët të dërguar nga organi i prokurorisë.

Ndërsa në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të kujdestarit ligjor, avokatit mbrojtës dhe të psikologut. Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve e dërguar nga organi i prokurorisë. Përgjegjësi i dhomave të sigurisë kishte listën e avokatëve dhe numrat e telefonave të tyre. Ndërsa psikologu sigurohej nga bashkia dhe shkolla e mesme e qytetit Dibër.

Të ndaluarve dhe arrestuarve iu jepeshin nga oficerët e policisë gjyqësore kopje të procesverbalit të ndalimit/arrestimit, të kontrollit personal dhe të letrës me të drejtat e tyre.

Grupi i inspektimit konstatoi se, vizitat mjekësore të personave të arrestuar/ndaluar **nuk** kryheshin brenda afatit 12 orësh nga momenti i vendosjes së këtyre personave në këtë ambient, sikurse përcaktohet në Procedurën standarde “Trajtimi dhe Sigurimi i Personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”<sup>5</sup>. Kjo për shkak se, kishte muaj që mungonte mjeku/ndihmësmjeku me kohë të plotë në organikën e Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër. Vizitat mjekësore e personave të arrestuar/ndaluar kryheshin nga personeli mjekësor i Spitalit Rajonal Dibër.

Mungesa e mjekut apo ndihmësmjekut në Drejtorinë Vendore të Policisë Dibër, çënon standardin për trajtim mjekësor të personave të arrestuar/ndaluar, për kohën që qëndrojnë në dhomat e sigurisë të Drejtorisë/komisariateve në varësi të saj.

Është rasti që të sjellim në vëmendjen e drejtuesve të organeve të policisë vendore Dibër se, prania e mjekut dhe kryerja e vizitave personave të arrestuar/ndaluar, brenda afatit 12 orë nga ora e arrestimit/ndalimit, është e parashikuar në procedurën standarde “Për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, e miratuar me Urdhrin nr.925, datë 18.07.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Në rastin e arrestimit të 13 personave në datë 28.06.2019, u konstatua se, në librin e kryerjes së vizitave mjekësore të personave të arrestuar/ndaluar në Komisaratin e Policisë Dibër janë pasqyruar vetëm data dhe ora e kryerjes së vizitave, por nuk është pasqyruar asnjë shënim lidhur me intervistimin, verifikimin dhe këqyrjen e jashtme të arrestuarve/ndaluarve, nëse ata kishin ose jo shënja të ushtrimit të dhunës, keqtrajtim, pretendimet e të arrestuarve dhe konstatimet, rekomandimet apo mjekimet e dhëna nga mjeku. Gjithashtu, punonjësit e shërbimit në dhomat e sigurisë, nuk kishin mbajtur procesverbal verifikimi/konstatimi, i cili nënshkruhet nga të gjithë personat e përfshirë në verifikim-konstatim.

---

<sup>5</sup> *Kreu V, pika 7/7.2 e procedurës standarde “Trajtimi dhe Sigurimi i Personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”.*

Ndërkohë u konstatua se, në këtë Komisarariat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në Kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse.

Gjithashtu në këtë Komisarariat kishte edhe regjistër për evidentimin e ankesave dhe kërkesave të personave të ndaluar/arrestuar dhe të shoqëruar. Nga verifikimi tij rezultoi se, për vitin 2019 nuk ishte regjistruar asnjë ankesë apo kërkesë nga personat e ndaluar/arrestuar dhe të shoqëruar.

Për sa më sipër dhe me qëllim zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë këtij inspektimi, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike” dhe në bazë të nenit 21/b të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”,

### **REKOMANDOJMË :**

1. Marrjen e masave për mbylljen e ambienteve ekzistuese të sigurisë në Komisariatin e Policisë Dibër, si dhe ndërtimin e ambienteve të reja sipas kërkesave të procedurës standarde “Trajtimi dhe Sigurimi i Personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, miratuar me Urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019.

Deri në marrjen e vendimit nga organi përgjegjës i ngarkuar me ligj për mbylljen e ambientit të sigurisë të Komisariatit të Policisë Dibër, kërkohet që në ambientin e sigurisë ekzistues të marren masat e menjëhershme për:

- 1.1 Plotësimin e dhomave të sigurisë me krevatë për fjetjen e personave të arrestuar/ndaluar, brenda kapacitetit të këtyre dhomave;
- 1.2 Heqjen nga përdorimi të materialeve të fjetjes ekzistuese dhe zëvendësimin e tyre me materiale të reja, si dyshekë, batanie, jastëk;
- 1.3 Krijimin e një ambienti (dhome) të veçantë hetimi për të miturit gjatë marrjes në pyetje/intervistimin e tyre me kushte të përshtatshme, orenditë e nevojshme, sistem ajrimi dhe ndriçim të plotë natyral dhe artificial;
- 1.4 Zgjerimin e përmasave të dritareve të dhomave të sigurisë, pasi ato janë shumë të vogla dhe nuk lejojnë ajrimin dhe ndriçimin e plotë natyral;
- 1.5 Kryerjen e investimit për izolimin e brendshëm dhe të jashtëm të dhomave të sigurisë, me qëllim uljen e nivelit të lagështirës brenda këtyre ambienteve.
- 1.6 Dizifektimin, lysterjen dhe pastërtinë brenda dhomave dhe koridorit të ambientit të sigurisë, për largimin e erërave të këqia që e ndotin ambientin;
- 1.7 Sigurimin e pajisjeve elektrike, që garantojnë ngrohjen në periudhën e dimrit, për shkak të kushteve të këqia atmosferike të kësaj zone;
- 1.8 Vendosjen e sistemit të kamerave për mbajtjen në vëzhgim të koridorit, dhomave të sigurisë dhe dhomës për marrjen në pyetje të shtetasve të arrestuar/ndaluar.

2. Marrjen e masave për ndërtimin dhe vënien në funksion të ambienteve të shoqërimit në këtë Komisariat, sipas kërkesave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe Procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr.306, datë 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, të ndara më vete për femrat, meshkujt madhorë dhe të miturit, me kushte të përshtatshme dhe dinjitoze, të pajisura me orenditë e nevojshme për qëndrim dhe të monitoruara me sistemin e kamerave.
3. Marrjen e masave të menjëhershme për kompletimin e organikës të Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër me mjek/ndihmësmjek me kohë të plotë, për kryerjen e vizitave mjeksore të personave të ndaluar/arrestuar kur ndodhen në mjediset e policisë.
4. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e dhomës (zyrës) për marrjen në pyetje/intervistimin nga oficerët e policisë gjyqësore e personave të shoqëruar, para se ata të kalojnë në ambientin e sigurisë dhe instalimin brenda saj të sistemit të monitorimit me kamera.
5. Marrjen e masave të menjëhershme për rastet kur personat e shoqëruar në organet e policisë vendoset arrestimi apo ndalimi, punonjësi i policisë në procesverbalin e arrestimit në flagrancë ose të ndalimit, duhet të vendosë orën e shoqërimit të tyre dhe jo ora kur përpilohet procesverbali i arrestimit/ndalimit.
6. Marrjen e masave të nevojshme për rikonstruksionin dhe vënien në funksion të tualetit që ndodhet në ambientin e shoqërimit.
7. Marrjen e masave të menjëhershme për instalimin e sistemi qëndror të ngrohjes në ambientin e sigurisë, por dhe në ambientin e shoqërimit të këtij Komisariati, për shkak të kushteve të rënduara atmosferike që ka kjo zonë.
8. Marrjen e masave të menjëhershme, për trajnimin e stafit të policisë për njohjen me kartën e të drejtave që gëzojnë personat e ndaluar/arrestuar, që në momentin e hyrjes në ambientin e sigurisë, për të garantuar zbatimin korrekt dhe në mënyrë efektive të të drejtave të këtyre personave.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit Nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.*

**KOMISIONER**

**Ermonela XHAFA**